

AKT THEMELIMI
I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR
“ALBANIA HUMAN CAPITAL”

Sot me date 29/07/2021:

Edvin Kepi, shtetas shqiptar, lindur ne Tirane me 16/02/1978 dhe banues ne Tirane, madhor me zotesi te plote juridike e per te vepruar, identifikuar me Karte Identiteti Nr.036026864.

DHE

Elvis Himçi, shtetas shqiptar, lindur ne Vlore me 18/08/1986 dhe banues ne Tirane, madhor me zotesi te plote juridike e per te vepruar, identifikuar me Karte Identiteti Nr.036431594

Kemi vendosur të nënshkruajmë Aktin e Themelimit të mëposhtëm të një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar, aktiviteti i së cilës rregullohet nga legjislacioni shqiptar, nga përcaktimet në këtë akt themelimi dhe në fuqi dhe nga statuti i saj, i cili është pjesë përbërëse e këtij akti.

Neni 1 – Emërtimi

Emërtimi i shoqërisë është “Albania Human Capital”

Neni 2 – Selia

Selia e shoqërisë ndodhet ne Rr. “Medar Shtylla” Nr. 40, Njesia Nr.5, Tirane

Neni 3 – Kohëzgjatja

Kohëzgjatja e veprimtarisë së shoqërisë do të jete me afat te pacaktuar dhe fillon me regiistrimin e shoqërisë ne Regjistrin Tregtar. Ortakët e Shoqërisë mund te vendosin kufizimin e afatit te veprimtarisë dhe me pas zgjatjen e saj nje apo disa here sipas nje vendimi te posacem.

Neni 4 – Objekti i shoqërisë

Objekti i shoqërisë është:

1. Rekrutimin e punonjësve të huaj në RSH;
2. Punësimi i punonjësve në pozicione të ndryshme pune sipas aftësisë dhe preferencave të tyre.

3. Agjenci Turistike, organizim udhëtimesh individuale ose në grupe për shtetas shqiptar dhe të huaj brenda dhe jashtë vendit, promovimi i turzimit në Shqipëri dhe jashtë saj, shitje biletash, transport turistik tokesor.

Neni 5 – Kapitali themeltar

Kapitali themeltar i shoqerise eshte 100 Lekë, i ndarë në 2 kuota.

Kapitali i mesiperm eshte nënshkruar tërësisht nga ortakët e shoqerise perkatesisht:

Edvin Kepi, zoterues i 1 kuote, që perfaqesojne 50 % të kapitalit themeltar të shoqerisë, me vlere te pergjithshme 50 lekë.

Elvis Himçi, zoterues i 1 kuote, që perfaqesojne 50 % të kapitalit themeltar të shoqerisë, me vlere te pergjithshme 50 lekë.

Neni 6 - Transferimi kuotave

Kuotat i transferohen te treteve sipas parashikimeve te statutit.

Neni 7 – Organet Drejtuese

Bazuar ne dispozitat e ligjit nr. 9901, date 14/04/2008 "Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare", organet drejtuese te shoqerise jane si me poshte vijon:

1. Asambleja e Pergjithshme e Ortakeve – organi me i larte vendimmarres;
2. Administratoret - organi ekzekutiv dhe administrativ i shoqerise.

Menyra e organizimit te tyre dhe funksionimit eshte e percaktuar ne Statutin e Shoqerise.

Shoqeria do te administrohet nga Administratoret te cilet zgjidhen per nje afat pese vjecar me te drejte rizgjedhjeje.

Administratori i pare i Shoqerise do te jete Z. Edvin Kepi, shtetas shqiptar, i datelindjes 16/02/1978 banues ne Tirane, madhor me zotesi te plote juridike dhe per te vepruar, identifikuar nga leternjoftimi nr. 036026864, per nje periudhe 5 (pese) vjecare me te drejte ripeneritjeje.

Shoqeria perfaqesohet prane cdo organi administrative, gjyqesor, enti public apo privat, si dhe ne marredhenie me te tretet nga administratoret te cilet ushtrojne keto te drejta ne perputhje me Statutin e shoqerise dhe legjislacionin ne fuqi.

Neni 8 – Organizimi

Organizimi dhe funksionimi i shoqerise, ngritja e degeve apo filialeve te saj do te behet ne perputhje me dispozitat perkatese te ligjit dhe statutit.

Neni 9 – Ligji i aplikueshem

Veprimtaria e shoqerise rregullohet nga organet e statutit te nenshkuara nga ortaku themelues dhe te noterizuara perpara meje, sipas ligjit ne fuqi ne Republiken e Shqiperise.

Akti i Themelimit hartohet ne 3 (tre) kopje ne gjuhen shqipe, dhe pasi u lexua nga ortaku themelues, u nenshkrua para mua Noterit dhe une e noterizova.

**ORTAKËT THEMELUES
TË SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR**

Albania Human Capital

Z. Edvin Kepi

Z. Elvis Himçi

